

FONDI I PENSIONIT PRIVAT ALBSIG

PASQYRAT FINANCIARE

30 qershor 2025

(të paaudituar)

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Pasqyra e aktiveve të fondit të pensionit privat
2. Pasqyra e veprimtarisë së fondit të pensionit privat
3. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto
4. Pasqyra mbi kuotat e fondit të pensionit privat
5. Pasqyra e strukturës së investimeve (Obligacionet, Depozitat me afat, Investime të tjera)
6. Pasqyra e treguesve të portofolit të fondit të pensionit privat
7. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të perealizuara të fondit të pensionit privat, obligacione (në Lekë)
8. Tabela e kontributeve të derdhura në fondin e pensionit privat
9. Shënimet shpjeguese

1. Pasqyra e aktiveve të fondit të pensionit privat

Emri i fondit të pensionit: Fondi Privat i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.06.2025

Zërat e aktivitet	Lekë	Lekë
	31.12.2024	30.06.2025
1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	11,538,619.63	12,628,776.41
2. Investime (2.1+2.2+2.3+2.4)	678,298,840.80	802,821,488.61
2.1 Tituj borxhi të blerë në emetimin e parë (2.1.a+2.1.b+2.1.c)	406,873,161.86	443,055,968.35
2.1.a Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes	0.00	0.00
2.1.b Investime financiare përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse	0.00	0.00
2.1.c Investime financiare të mbajtura deri në maturim (kosto të amortizuar)	406,873,161.86	443,055,968.35
2.2 Tituj borxhi të blerë në treg sekondar (2.2.a+2.2.b+2.2.c)	271,425,678.94	359,765,520.27
2.2.a Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humbjes	0.00	0.00
2.2.b Investime financiare përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse	0.00	0.00
2.2.c Investime financiare të mbajtura deri në maturim (kosto të amortizuar)	271,425,678.94	359,765,520.27
2.3 Depozita	0.00	0.00
2.4 Tituj të tjerë (2.4.a+ 2.4.b)	0.00	0.00
2.4.a. Aksione/Kuota në sipërmarrje të vetme të investimeve kolektive	0.00	0.00
2.4.b. Tituj të tjerë	0.00	0.00
3. Llogari të arkëtueshme (3a+3b+3c+3d+3e+3f)	14,788,873.82	17,728,000.46
3a. Të arkëtueshme nga shitja e letrave me vlerë	0.00	0.00
3b. Të arkëtueshme nga shoqëria administruese	0.00	0.00
3c. Të arkëtueshme nga depozitari	0.00	0.00
3d. Parapagime	0.00	0.00
3e. Të arkëtueshme nga ndryshimi i anëtarësisë	0.00	0.00
3f. Të tjera llogari të arkëtueshme	14,788,873.82	17,728,000.46
A (1+2+3) TOTALI I AKTIVEVE	704,626,334.25	833,178,265.48
4. Detyrime nga investimi në tituj	0.00	0.00
5. Detyrime nga investimi në depozita	0.00	0.00
6. Detyrime ndaj shoqërisë administruese	1,472,481.42	1,682,762.11
7. Detyrime ndaj depozitarit	0.00	0.00
8. Detyrime nga ndryshimi i anëtarësisë	0.00	0.00
9. Pagesa të shtyra dhe të ardhura të marra në avancë	0.00	0.00
10. Detyrime të tjera	312,645.58	602,813.62
B (4+5+6+7+8+9+10) TOTALI I DETYRIMEVE	1,785,127.00	2,285,575.73

C (A-B) AKTIVET NETO TË FONDIT TË PENSIONIT	702,841,207.25	830,892,689.75
D NUMRI I KUOTAVE TË FONDIT TË PENSIONIT	608,409.7405	704,799.1004
E (C/D) AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË PENSIONIT	1,155.2103	1,178.9071

2. Pasqyra e veprimtarisë së fondit të pensionit privat

Emri i fondit të pensionit: Fondi Privat i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.06.2025

		Lekë	Lekë
Nr.	Zërat e aktivitetit	30.06.2024	30.06.2025
	TË ARDHURA NGA INVESTIMET		
1	Fitime të realizuara nga shitja e investimeve në tituj	0.00	0.00
2	Të ardhura nga interesat	17,182,932.83	24,742,645.00
3	Diferenca pozitive të kurseve të këmbimit nga mjetet monetare	0.00	0.00
4	Të ardhura nga dividendët	0.00	0.00
5	Të ardhura nga interesat e depozitave	150,983.53	250,379.79
6	Të ardhura të tjera	443.14	415.22
A (1+2+3+4+5+6)	TOTALI I TË ARDHURAVE NGA INVESTIMET	17,334,359.50	24,993,440.01
	SHPENZIMET		
7	Humbje të realizuara nga shitja e investimeve në tituj	0.00	0.00
8	Diferenca negative të kurseve të këmbimit nga mjetet monetare	0.00	0.00
9	Tarifa për shoqërinë administruese	6,595,703.71	9,432,786.27
10	Tarifa për depozitarin	0.00	0.00
11	Shpenzime të tjera/provigjone	-285.73	-414.18
B (7+8+9+10-11)	TOTALI I SHPENZIMEVE	6,595,989.44	9,433,200.45
C (A-B)	FITIMI (HUMBJA) NETO NGA INVESTIMET, +/-	10,738,370.06	15,560,239.56
	FITIMI (HUMBJA) E PAREALIZUAR NGA INVESTIMET NË TITUJ		
d1	Fitimi (humbja) e parealizuar nga investimet në tituj, +/-	0.00	0.00
d2	Ndryshime neto prej kurseve të këmbimit në investimet në tituj	0.00	0.00
d3	Amortizimi i primit/diskountit të aktiveve me afat maturimi fiks	159,972.60	-119,711.15
d4	Zhvlerësim i aktiveve	0.00	0.00

D (d1+d2+d3+d4)	TOTALI I FITIMEVE (HUMBJEVE) TË PAREALIZUARA NGA INVESTIMET NË TITUJ, +/-	159,972.60	-119,711.15
E (C+D)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NETO I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT	10,898,342.66	15,440,528.41
F	TË ARDHURA GJITHËPËRFSHIRËSE		
	Zërat që mund të klasifikohen më pas në fitim ose humbje:	0.00	0.00
	Investime financiare të mbajtura përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse	0.00	0.00
	Fitim/humbjet që lindin gjatë vitit nga investime financiare të mbajtura përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse	0.00	0.00
	Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	0.00	0.00
	Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	0.00	0.00

3. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto

Emri i fondit të pensionit: Fondi Privat i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.06.2025

		Lekë	Lekë
Nr.	Zërat e aktivitetit	31.12.2024	30.06.2025
	RRITJA (ZVOGËLIMI) I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT		
1 (nga FPF 2C)	Fitimi (Humbja) neto nga investimet, +/-	23,889,465.44	15,560,239.56
2 (nga FPF 2D)	Totali i fitimeve (humbjeve) të përealizuara nga investimet në tituj, +/-	480,380.67	-119,711.15
3	Rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse	0.00	0.00
A (1+2+3)	RRITJA (ZVOGËLIMI) I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT	24,369,846.11	15,440,528.41
4	Kontribute nga anëtarët e fondit	215,522,400.21	136,966,960.38
5	Tërheqje për shkak të ndryshimit të anëtarësisë (-)	-1,100,836.81	-479,126.79
6	Tërheqje e menjëhershme pa mbushur moshën e pensionit privat (-)	-19,584,992.26	-15,364,551.74
7	Tërheqje e përfitimeve të pensionit mujor (-)	0.00	0.00
8	Tërheqje e menjëhershme e përfitimeve të pensionit (-)	-10,090,662.71	-8,512,327.76
B (4+5+6+7+8)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NË TOTAL NGA TRANSAKSIONET ME KUOTAT E PENSIONIT, +/-	184,745,908.43	112,610,954.09
C (A+B)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NË TOTAL I AKTIVEVE NETO, +/-	209,115,754.54	128,051,482.50

D	AKTIVET NETO		
9	Aktivet neto në fillim të periudhës	493,725,452.70	702,841,207.25
10	Aktivet neto në fund të periudhës	702,841,207.25	830,892,689.75
	NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT		
11	Kuota të pensionit të emetuara mbi bazën e kontributeve	190,068.2293	117,262.2497
12	Kuota të pensionit të tërhequra mbi bazën e ndryshimit të anëtarësisë (-)	-985.7114	-411.7931
13	Kuota për tërheqjet e menjëhershme pa mbushur moshën e pensionit /e parakohshme (-)	-17,255.1158	-13,164.2597
14	Kuota të tërheqjeve të pensioneve mujore (-)	0.0000	0.0000
15	Kuota të tërheqjeve të pensionit privat në mënyrë të menjëhershme (-)	-8,924.2532	-7,296.8370
E (11+12+13+14+15)	NUMRI I KUOTAVE TË PENSIONIT	162,903.1489	96,389.3599

4. Pasqyra mbi kuotat e fondit të pensionit privat

Emri i fondit të pensionit: Fondi Privat i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.06.2025

Lloji	Numri i kuotave të fondit	Aktivet neto të fondit (Lekë)	Aktivet neto për kuotë (Lekë)
Në fillim të periudhës 31.12.2024	608,409.7405	702,841,207.25	1,155.2103
Emetuar gjatë periudhës	117,262.2497	136,966,960.38	1,168.0397
Tërheqje për shkak të ndryshimit të anëtarësisë/transferim	411.7931	479,126.79	1,163.5134
Tërheqje e menjëhershme pa mbushur moshën e pensionit (tërheqje e parakohshme)	13,164.2597	15,364,551.74	1,167.1413
Tërheqje e përfitimeve të pensionit mujor	0.0000	0.00	0.0000
Tërheqje e menjëhershme e përfitimeve të pensionit	7,296.8370	8,512,327.76	1,166.5778
Në fund të periudhës 30.06.2025	704,799.1004	830,892,689.75	1,178.9071

5. Pasqyra e strukturës së investimeve

5.1 Pasqyra e strukturës së investimeve – Obligacionet

Emri i fondit të pensionit: Fondi Privat i Pensionit “ALBSIG”

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.06.2025

Lloji - ISIN	Tregu Primar Sekondar	Vlera nominale (Lekë)	Shpenzimet e blerjes (Lekë)	Vlera në datën e raportimit pa interesat e përlllogaritur / Vlera e tregut (Lekë)	Vlera kontabël (Lekë)	Pjesa ndaj kapitalit të emetuesit në %	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit në %
Obligacione të Qeverisë (brenda vendit)		802,100,000.00	802,941,199.74	802,821,488.60	820,544,988.15	20.38	96.36
Të mbajtura deri në maturim - kosto të amortizuar (HTM)	Treg Primar	452,400,000.00	442,973,161.84	443,055,968.35	451,929,824.87	11.87	53.18
Të mbajtura deri në maturim - kosto të amortizuar (HTM)	Treg Sekondar	349,700,000.00	359,968,037.90	359,765,520.25	368,615,163.28	8.51	43.18
7 vjeçare	Treg Sekondar	3,100,000.00	3,172,116.61	3,164,522.76	3,226,136.98	0.06	0.38
AL0029NF7Y29	Treg Sekondar	3,100,000.00	3,172,116.61	3,164,522.76	3,226,136.98	0.06	0.38
10 vjeçare	Treg Primar	72,300,000.00	72,738,522.91	72,691,719.63	74,426,681.31	0.92	8.72
AL022NF10Y31	Treg Primar	8,800,000.00	8,800,256.06	8,798,193.11	9,015,186.45	0.11	1.06
AL022NF10Y31	Treg Primar	33,400,000.00	33,886,418.75	33,844,081.11	34,667,669.44	0.41	4.06
AL020NF10Y30	Treg Primar	3,800,000.00	3,785,559.74	3,785,942.49	3,881,985.38	0.05	0.45
AL021NF10Y30	Treg Primar	10,000,000.00	10,002,379.33	10,000,108.59	10,220,508.59	0.15	1.20
AL021NF10Y30	Treg Primar	6,900,000.00	6,861,612.06	6,863,148.32	7,015,224.32	0.11	0.82
AL023NF10Y31	Treg Primar	9,400,000.00	9,402,296.97	9,400,246.01	9,626,107.13	0.09	1.13
10 vjeçare	Treg Sekondar	54,500,000.00	55,550,862.59	55,472,027.56	56,903,894.47	0.73	6.66
AL022NF10Y31	Treg Sekondar	8,000,000.00	8,073,748.64	8,066,662.76	8,263,929.43	0.10	0.97
AL022NF10Y31	Treg Sekondar	5,000,000.00	5,151,551.53	5,139,524.12	5,262,815.78	0.06	0.62
AL020NF10Y30	Treg Sekondar	900,000.00	911,493.46	910,273.91	933,020.91	0.01	0.11
AL020NF10Y30	Treg Sekondar	3,000,000.00	3,038,372.94	3,034,302.31	3,110,125.65	0.04	0.36
AL020NF10Y30	Treg Sekondar	3,300,000.00	3,346,942.51	3,342,045.15	3,425,450.82	0.05	0.40
AL020NF10Y30	Treg Sekondar	5,100,000.00	5,154,497.66	5,148,527.99	5,277,427.66	0.07	0.62

AL021NF10Y30	Treg Sekondar	2,500,000.00	2,530,443.92	2,527,539.99	2,582,639.99	0.04	0.30
AL021NF10Y30	Treg Sekondar	5,100,000.00	5,127,537.72	5,124,326.79	5,236,730.79	0.08	0.62
AL023NF10Y31	Treg Sekondar	4,800,000.00	4,859,815.89	4,854,913.18	4,970,246.52	0.05	0.58
AL023NF10Y31	Treg Sekondar	5,600,000.00	5,678,442.69	5,672,149.34	5,806,704.90	0.05	0.68
AL000A3LCP92	Treg Sekondar	11,200,000.00	11,678,015.63	11,651,762.02	12,034,802.02	0.18	1.40
15 vjeçare	Treg Primar	344,000,000.00	334,134,638.93	334,271,908.68	340,763,478.52	9.44	40.12
AL000A3L2RM7	Treg Primar	47,200,000.00	47,204,840.59	47,190,551.79	48,316,193.13	1.23	5.66
AL000A3LUSF9	Treg Primar	30,200,000.00	30,198,742.27	30,188,238.88	31,000,853.77	0.85	3.62
AL002NF15Y37	Treg Primar	25,000,000.00	25,001,288.04	24,991,791.66	25,521,993.05	1.16	3.00
AL002NF15Y37	Treg Primar	44,000,000.00	42,148,681.56	42,171,988.32	43,105,142.77	2.05	5.06
AL001NF15Y36	Treg Primar	21,500,000.00	21,499,835.46	21,494,170.45	21,669,753.78	0.51	2.58
AL001NF15Y36	Treg Primar	30,000,000.00	30,099,024.09	30,088,187.44	30,333,187.44	0.71	3.61
AL001NF15Y36	Treg Primar	53,900,000.00	49,508,477.73	49,615,754.26	50,055,937.59	1.27	5.96
AL000A3LDXP4	Treg Primar	40,500,000.00	39,551,379.45	39,561,454.14	40,540,654.14	0.73	4.75
AL000A3LDXP4	Treg Primar	40,000,000.00	38,332,190.93	38,358,683.74	39,325,794.85	0.72	4.60
AL000A3LDXP4	Treg Primar	11,700,000.00	10,590,178.81	10,611,088.00	10,893,968.00	0.21	1.27
15 vjeçare	Treg Sekondar	211,100,000.00	212,702,699.74	212,614,698.13	217,682,610.03	4.90	25.52
AL000A3LDXP4	Treg Sekondar	14,300,000.00	13,250,472.22	13,269,738.43	13,615,480.65	0.26	1.59
AL000A3L2RM7	Treg Sekondar	12,300,000.00	12,549,462.79	12,540,697.80	12,834,032.30	0.32	1.51
AL000A3L2RM7	Treg Sekondar	15,000,000.00	15,345,412.89	15,333,870.87	15,691,595.87	0.39	1.84
AL000A3L2RM7	Treg Sekondar	25,900,000.00	27,826,515.41	27,777,821.54	28,395,493.38	0.68	3.33
AL000A3LUSF9	Treg Sekondar	5,300,000.00	5,409,714.75	5,405,680.20	5,548,291.42	0.15	0.65
AL000A3LUSF9	Treg Sekondar	25,600,000.00	27,153,038.31	27,112,061.19	27,800,900.30	0.72	3.25
AL000A3LUSF9	Treg Sekondar	11,800,000.00	12,558,329.42	12,538,517.29	12,856,029.07	0.33	1.51
AL000A3LUSF9	Treg Sekondar	10,000,000.00	10,652,250.04	10,635,250.52	10,904,328.30	0.28	1.28
AL000A3LUSF9	Treg Sekondar	6,800,000.00	7,445,371.33	7,429,299.43	7,612,272.32	0.19	0.89
AL001NF15Y36	Treg Sekondar	11,300,000.00	10,640,872.17	10,656,471.81	10,748,755.15	0.27	1.28
AL000A3LDXP4	Treg Sekondar	20,400,000.00	20,580,552.48	20,570,062.83	21,063,289.49	0.37	2.47
AL000A3LDXP4	Treg Sekondar	9,600,000.00	9,437,171.51	9,438,124.82	9,670,231.49	0.17	1.13
AL000A3LDXP4	Treg Sekondar	32,100,000.00	29,889,844.55	29,930,024.79	30,706,131.46	0.58	3.59
AL000A3LDXP4	Treg Sekondar	10,700,000.00	9,963,691.87	9,977,076.61	10,235,778.83	0.19	1.20

20 vjecare	Treg Primar	36,100,000.00	36,100,000.00	36,092,340.04	36,739,665.04	1.51	4.33
AL000A3L78Y8	Treg Primar	21,200,000.00	21,200,000.00	21,193,721.64	21,792,621.64	0.74	2.54
AL000A4EB3P0	Treg Primar	14,900,000.00	14,900,000.00	14,898,618.40	14,947,043.40	0.77	1.79
20 vjecare	Treg Sekondar	81,000,000.00	88,542,358.96	88,514,271.80	90,802,521.80	2.82	10.62
AL000A3L78Y8	Treg Sekondar	33,000,000.00	35,960,460.66	35,942,950.49	36,875,200.49	1.15	4.31
AL000A3L78Y8	Treg Sekondar	48,000,000.00	52,581,898.30	52,571,321.31	53,927,321.31	1.67	6.31
TOTALI PËR OBLIGACIONET E EMETUESVE VENDAS		802,100,000.00	802,941,199.74	802,821,488.60	820,544,988.15	20.38	96.36

5.2 Pasqyra e strukturës së investimeve – Depozitat me afat

Emri i fondit të pensionit: Fondi Privat i Pensionit “ALBSIG”

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.06.2025

Lloji	Vlera në momentin depozitimit	Vlera në datën e raportimit (Lekë)	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit në %	Data e maturimit
Depozita të tjera (<=3 mujore)	10,660,000.00	10,664,500.95	1.28	01.07.2025
D398	5,700,000.00	5,703,006.16	0.68	01.07.2025
D399	4,960,000.00	4,961,494.79	0.60	01.07.2025
Depozita afatshkurtër (> 3 muaj dhe <= 1 vit)	0.00	0.00	0.00	0.00
Depozita afatgjatë (> 1 vit)	0.00	0.00	0.00	0.00
TOTALI I AKTIVEVE	833,178,265.48		100.00	
TOTALI I DEPOZITAVE	10,660,000.00	10,664,500.95	1.28	01.07.2025

5.3 Pasqyra e strukturës së investimeve – Investime të tjera

Emri i fondit të pensionit: Fondi Privat i Pensionit “ALBSIG”

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.06.2025

Lloji	Vlera në datën e raportimit (Lekë)	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit në %
B0	1,968,776.41	0.24
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (brenda vendit)	1,968,776.41	0.24
Aktive të tjera (brenda vendit)	17,728,000.46	2.13
TOTALI BRENDA VENDIT	19,696,776.87	2.36
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (jashtë vendit)	0.00	0.00
Aktive të tjera (jashtë vendit)	0.00	0.00
TOTALI JASHTË VENDIT	0.00	0.00
TOTALI I AKTIVEVE	833,178,265.48	100.00

6. Pasqyra e treguesve të portofolit të fondit të pensionit privat

Për periudhën: 30.06.2025

Obligacionet Maturiteti i mbetur	Deri në 1 vit	> 1 vit deri në 2 vjet	> 2 vjet deri në 3 vjet	> 3 vjet deri në 5 vjet	> 5 vjet deri në 7 vjet	> 7 vjet	Totali
Vlera në Lekë	0.00	0.00	0.00	19,385,614.62	100,290,893.33	683,144,980.67	802,821,488.61
Në %	0.00%	0.00%	0.00%	2.41%	12.49%	85.09%	100.00%
Modified Duration	8.18						

7. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të perealizuara të fondit të pensionit privat, obligacione (në Lekë)

Emri i fondit të pensionit: Fondi Privat i Pensionit “ALBSIG”

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.06.2025

Tituj	ISIN	Data e blerjes	Shpenzimet e blerjes	Vlera e tregut	Fitimi i perealizuar nga ndryshimi i çmimit	Rivlerësimi i aktiveve të mbajtura përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse	Ndryshimi neto në vlerën e investimit nga kursi i këmbimit	Amortizimi i primit/diskauntit të aktiveve me afat maturimi fiks	Zhvlerësimi i aktiveve
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LCP92	22.02.2023	11,678,015.63	11,651,762.02	0.00	0.00	0.00	-26,253.61	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LDXP4	12.06.2023	20,580,552.48	20,570,062.83	0.00	0.00	0.00	-10,489.66	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LDXP4	10.11.2023	29,889,844.55	29,930,024.79	0.00	0.00	0.00	40,180.24	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LDXP4	24.11.2023	9,963,691.87	9,977,076.61	0.00	0.00	0.00	13,384.74	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LDXP4	04.05.2023	39,551,379.45	39,561,454.14	0.00	0.00	0.00	10,074.69	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LDXP4	29.12.2023	13,250,472.22	13,269,738.43	0.00	0.00	0.00	19,266.21	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LDXP4	03.11.2023	9,437,171.51	9,438,124.82	0.00	0.00	0.00	953.31	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LDXP4	20.09.2023	38,332,190.94	38,358,683.74	0.00	0.00	0.00	26,492.80	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LDXP4	05.10.2023	10,590,178.81	10,611,088.00	0.00	0.00	0.00	20,909.19	0.00

Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LUSF9	04.09.2024	7,445,371.33	7,429,299.43	0.00	0.00	0.00	-16,071.90	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LUSF9	18.07.2024	10,652,250.05	10,635,250.52	0.00	0.00	0.00	-16,999.52	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LUSF9	28.02.2024	30,198,742.27	30,188,238.88	0.00	0.00	0.00	-10,503.39	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LUSF9	03.07.2024	12,558,329.42	12,538,517.29	0.00	0.00	0.00	-19,812.12	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LUSF9	15.03.2024	5,409,714.75	5,405,680.20	0.00	0.00	0.00	-4,034.55	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3LUSF9	16.05.2024	27,153,038.31	27,112,061.19	0.00	0.00	0.00	-40,977.12	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3L2RM7	19.11.2024	15,345,412.89	15,333,870.87	0.00	0.00	0.00	-11,542.02	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3L2RM7	23.08.2024	47,204,840.59	47,190,551.80	0.00	0.00	0.00	-14,288.79	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3L2RM7	25.11.2024	27,826,515.42	27,777,821.54	0.00	0.00	0.00	-48,693.87	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3L2RM7	03.10.2024	12,549,462.79	12,540,697.80	0.00	0.00	0.00	-8,764.99	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3L78Y8	12.05.2025	52,581,898.30	52,571,321.31	0.00	0.00	0.00	-10,576.99	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3L78Y8	28.01.2025	21,200,000.00	21,193,721.64	0.00	0.00	0.00	-6,278.36	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A3L78Y8	19.03.2025	35,960,460.66	35,942,950.49	0.00	0.00	0.00	-17,510.17	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL000A4EB3P0	10.06.2025	14,900,000.00	14,898,618.40	0.00	0.00	0.00	-1,381.60	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL001NF15Y36	24.05.2022	10,640,872.17	10,656,471.81	0.00	0.00	0.00	15,599.64	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL001NF15Y36	18.02.2022	30,099,024.09	30,088,187.44	0.00	0.00	0.00	-10,836.66	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL001NF15Y36	11.05.2022	49,508,477.74	49,615,754.26	0.00	0.00	0.00	107,276.52	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL001NF15Y36	10.11.2021	21,499,835.46	21,494,170.45	0.00	0.00	0.00	-5,665.01	0.00

Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL002NF15Y37	24.11.2022	42,148,681.56	42,171,988.32	0.00	0.00	0.00	23,306.77	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL002NF15Y37	29.09.2022	25,001,288.04	24,991,791.66	0.00	0.00	0.00	-9,496.39	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL0029NF7Y29	22.02.2023	3,172,116.61	3,164,522.76	0.00	0.00	0.00	-7,593.85	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL020NF10Y30	17.03.2020	3,346,942.51	3,342,045.15	0.00	0.00	0.00	-4,897.36	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL020NF10Y30	22.05.2020	5,154,497.66	5,148,527.99	0.00	0.00	0.00	-5,969.67	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL020NF10Y30	06.02.2020	911,493.46	910,273.91	0.00	0.00	0.00	-1,219.56	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL020NF10Y30	14.04.2020	3,785,559.74	3,785,942.49	0.00	0.00	0.00	382.75	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL020NF10Y30	24.02.2020	3,038,372.94	3,034,302.31	0.00	0.00	0.00	-4,070.62	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL021NF10Y30	26.11.2020	5,127,537.72	5,124,326.79	0.00	0.00	0.00	-3,210.93	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL021NF10Y30	14.10.2020	6,861,612.06	6,863,148.32	0.00	0.00	0.00	1,536.26	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL021NF10Y30	24.08.2020	2,530,443.92	2,527,539.99	0.00	0.00	0.00	-2,903.92	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL021NF10Y30	28.07.2020	10,002,379.33	10,000,108.59	0.00	0.00	0.00	-2,270.74	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL022NF10Y31	26.05.2021	5,151,551.53	5,139,524.12	0.00	0.00	0.00	-12,027.41	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL022NF10Y31	25.02.2021	8,073,748.64	8,066,662.76	0.00	0.00	0.00	-7,085.87	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL022NF10Y31	21.04.2021	33,886,418.75	33,844,081.11	0.00	0.00	0.00	-42,337.65	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL022NF10Y31	15.01.2021	8,800,256.07	8,798,193.11	0.00	0.00	0.00	-2,062.95	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL023NF10Y31	08.09.2021	5,678,442.69	5,672,149.34	0.00	0.00	0.00	-6,293.35	0.00
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL023NF10Y31	07.07.2021	9,402,296.97	9,400,246.02	0.00	0.00	0.00	-2,050.96	0.00

Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM)	AL023NF10Y31	26.07.2021	4,859,815.89	4,854,913.18	0.00	0.00	0.00	-4,902.71	0.00
Obligacione të Qeverisë			802,941,199.76	802,821,488.61	0.00	0.00	0.00	- 119,711.15	0.00
HTM			802,941,199.76	802,821,488.61	0.00	0.00	0.00	- 119,711.15	0.00
Totali i fitimeve (humbjeve) të përcaktuara			802,941,199.76	802,821,488.61	0.00	0.00	0.00	- 119,711.15	0.00
Ripërmbledhja sipas kategorive:									
Fitime (humbje) të realizuara nga aktive financiare të mbajtura deri në maturim (kosto të amortizuara)			802,941,199.76	802,821,488.61	0.00	0.00	0.00	- 119,711.15	0.00

8. Tabelat e kontributeve të derdhura në fondin e pensionit

Emri i fondit të pensionit: Fondi Privat i Pensionit "ALBSIG"

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.06.2025

Gjëndja e kontributeve të anëtarëve deri më 30.06.2025 (në Lekë)	Vlera në Lek
Nga anëtarë vullnetarë	106,828,130.87
Punonjës + Punëdhënës	741,678,206.55
Totali	848,506,337.42
Punonjës + Punëdhënës:	
Kontributet e punëdhënësve	512,513,133.49
Kontributet e punonjësve	229,165,073.06
Totali	741,678,206.55

Kontribute të derdhura nga fillimi viti -periudha aktuale 01.01.2025 – 30.06.2025 (në Lekë)	Vlera në Lek
Nga anëtarë vullnetarë	9,803,741.40
Punonjës + Punëdhënës	127,163,220.02
Totali	136,966,961.42
Punonjës + Punëdhënës:	
Kontributet e punëdhënësve	96,644,124.81
Kontributet e punonjësve	30,519,095.21
Totali	127,163,220.02

9. Shënime të pasqyrave financiare të fondit të pensionit

Emri i fondit të pensionit: Fondi Privat i Pensionit “ALBSIG”

Kodi i fondit të pensionit: FP 4

Emri i shoqërisë administruese: Albsig Invest

Për periudhën: 30.06.2025

1. Informacion i përgjithshëm

Fondi i Pensionit Privat Albsig (tani e tutje do i referohemi si “Fondi”) u krijua në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 76/2023, “Për Fondet e Pensionit Privat” (tani e tutje do i referohemi si “Ligji”), i ndryshuar; dhe u licencua nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (tani e tutje do i referohemi si “AMF”), me vendimin numër 210, datë 22 nëntor 2019.

Shoqëria Administruese e Fondeve është Albsig Invest sh.a., (tani e tutje do i referohemi si “Shoqëria Administruese”), e cila është një shoqëri aksionare, e themeluar në tetor të vitit 2019, dhe e licencuar nga AMF, me vendimin numër 210, datë 22 nëntor 2019.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë Administruese dhe e Fondit është Bulevardi “Bajram Curri”, Albsig HQ, Kati 16, Tiranë, Shqipëri.

Fondi i Pensionit u krijua nëpërmjet kontributeve në kuota nga të gjithë anëtarët e tij, dhe zotërohet plotësisht nga ata kontribues mbajtës të kuotave. Fondi investon kryesisht në letra me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare.

Banka e Tiranës është banka depozitare e Fondit e miratuar nga AMF. Banka depozitare bazuar në kërkesat e Ligjit, bën të mundur ruajtjen e aktiveve të Fondit në përputhje me kërkesat e Shoqërisë Administruese.

2. Bazat e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") dhe interpretimet e përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të aktiveve financiare të mbajtura me vlerën e drejtë, të cilat maten në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes.

c) Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit

Pasqyrat financiare janë paraqitur në monedhën shqiptare "Lek", që është monedha funksionale dhe prezantuese e fondit dhe të gjitha vlerat janë të shprehura në Lek përveç se kur është shprehur ndryshe.

Monedha funksionale është monedha e ambientit primar ekonomik në të cilin Fondi vepron. Investimet dhe veprimet e Fondit kryhen në Lek. Shpenzimet (duke përfshirë tarifat për Shoqërinë Administruese, Bankën Depozitare dhe të tjera) kryhen në Lek. Për rrjedhojë Këshilli i Administrimit ka përcaktuar Lekun si monedhën funksionale të Fondit.

d) Parimi i vijimësisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë dhe nuk përfshijnë ndonjë rregullim të vlerës kontabël dhe klasifikimit të aktiveve, detyrimeve dhe shpenzimeve të raportuara që përndryshe mund të kërkojnë nëse baza e parimit të vijimësisë nuk do të ishte e përshtatshme.

Drejtimi i Fondit beson se ka aktive të mjaftueshme dhe se ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar qëndrueshmëri dhe zhvillim të biznesit në kushtet aktuale.

e) Gjykimet kontabël dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare, kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në vlerën e mbartur të aktiveve dhe detyrimeve, si edhe të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën kur këto vlerësime rishikohen dhe gjithashtu në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

3. Politikat kontabël të rëndësishme

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme zbatohen për herë të parë në periudhat e raportimit financiar që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2024:

Disa standarde të cilat janë bërë efektive nga 1 janar 2024 dhe rrjedhimisht kanë hyrë në fuqi, nuk kanë ndikim të rëndësishëm në rezultatin apo pozicionin financiar të Shoqërisë.

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto Pasqyra Financiare dhe për këtë arsye shpalosjet nuk janë bërë.

a) Standardet e reja që mund të adoptohen më herët

- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (Ndryshimet në SNK 1)
- Detyrimi i qirasë në një shitje dhe kthim me qira (Ndryshimet në SNRF 16)
- Marrëveshjet financiare të furnizuesit (Ndryshimet në SNK 7 dhe SNRF 7)
- Detyrimet afatgjata me marrëveshje (Ndryshimet në SNK 1)

b) Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara

- Mungesa e shkëmbyeshmërisë (Ndryshimet në SNK 21)
- Ndryshime në Klasifikimin dhe Matjen e Instrumenteve Financiare (Ndryshime në SNRF 9 dhe 7)
- SNRF 18 "Prezantimi dhe shpalosja në pasqyrat financiare"
- SNRF 19 'Filiale pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye shpalosjet nuk janë bërë.

a. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në Lek me kurset e këmbimit në datën e transaksioneve. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit nuk rivekëtohen në fund vit dhe maten me koston e tyre historike (konvertuar në monedhën funksionale me kursin e asaj date) përveç, aktiveve dhe detyrimeve jo-monetare të matura me vlerën e tregut të cilat konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës kur u percaktua vlera e tyre e tregut.

Fitimi apo humbja nga kurset e këmbimit, që rezulton nga kryerja e transaksioneve të tilla si dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të mbajtura në monedhë të huaj, njihet në fitim ose humbje, përveç instrumentave financiare që mbahen me VDFH, të cilat njihen si një komponent i të ardhurës neto nga instrumentat financiarë në VDFH.

b. Instrumentet financiare

i. Njohja dhe matja fillestare

Fondi fillimisht njeh në mënyrë të rregullt, transaksionet me aktivet financiare dhe detyrimet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitim humbjes ("VDFH") në datën e tregtimit, e cila është data kur Fondi bëhet palë kontraktuale e instrumentit. Aktivitetet e tjera financiare dhe detyrimet financiare njihen në datën në të cilën ato krijohen.

Një aktiv financiar ose një detyrim financiar matet në fillim me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit në rastin e elementëve të përcaktuar jo me VDFH, që i ngarkohen drejtpërdrejtë blerjes ose emetimit të tij.

ii. Klasifikimi dhe matja e mëpasshme

Klasifikimi i aktiveve financiare

Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet si i matur me koston e amortizuar ose me VDFH. Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse përmbush njëkohësisht dy kushtet si më poshtë si edhe nuk është i destinuar me VDFH:

- mbahet në një model biznesi i cili ka për qëllim të mbaj aktivet për të mbledhur flukset e parasë; dhe
- rrjedha e parasë, lind në data të përcaktuara, sipas kushteve kontraktuale, të cilat janë, vetëm pagesa principali dhe interesit (VPPI).

Të gjitha aktivet e tjera financiare të Fondit maten me VDFH.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Në gjykimin e tij mbi vlerësimin e objektivave të modelit të biznesit në të cilin mbahet një aktiv, Fondi merr parasysh të gjithë informacionin relevant mbi mënyrën se si biznesi po administrohet duke përfshirë:

- politikat dhe objektivat e përcaktuara të portofolit dhe zbatimi i tyre në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e drejtimit fokusohet në përfitimin e të ardhurave kontraktuale nga interesi, mbajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto aktive ose realizimin e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modeleve të biznesit;
- frekuencën, volumin dhe kohën e shitjeve në periudhat e kaluara.

Fondi ka dy modele biznesi.

Modeli i biznesit mbajtje deri në mbledhje: ky model përfshin paranë dhe ekuivalentet e saj, aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuar dhe të arkëtueshme. Këto aktive financiare mbahen në mënyrë që të mbidhen flukset kontraktuale të parasë.

Model tjetër biznesi: kjo përfshin letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare dhe bonot e thesarit. Këto aktive financiare menaxhohen dhe performanca e tyre vlerësohet, mbi bazën e vlerës së drejtë, meqenëse ndodh shpesh tregtimi i tyre në treg.

Riklasifikimet

Aktivitetet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, përveç nëse Fondi ndryshon modelin e tij të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare. Në këtë rast të gjithë aktivet financiare që ndikohen, do të riklasifikohen në datën e parë në periudhën e parë raportuese që vijon ndryshimin e modelit të biznesit.

Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

Aktivitetet financiare me VDFH

Këto aktive financiare maten më pas me vlerën e drejtë. Fitimet ose humbjet neto, duke përfshirë të ardhura ose shpenzime nga interesi, ose kurset e këmbimit, njihen në fitim humbje, në të ardhura neto nga instrumentet financiare në VDFH, në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivitet financiar me kosto të amortizuar

Këto aktive maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga interesi njihen në të ardhura nga interesi sipas metodës së interesit efektiv, fitim humbjet nga kurset e këmbimit njihen në fitim humbje neto nga kurset e këmbimit, dhe humbjet nga zhvlerësimi njihen në humbje nga zhvlerësimi i instrumentave financiarë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje në njohjen fillestare gjithashtu njihet në fitim humbje. Letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare dhe paraja dhe ekuivalentet e saj përfshihen në këtë kategori.

Detyrimet financiare – Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitim ose humbjet

Detyrimet financiare klasifikohen dhe maten me kosto të amortizuar ose në VDFH. Një detyrim financiar klasifikohet si VDFH nëse ai klasifikohet si i mbajtur për tregtim, nëse ai është një derivativ ose nëse është i destinuar si i tillë në njohjen fillestare. Detyrimet financiare në VDFH maten me vlerën e drejtë dhe fitim humbjet neto, duke përfshirë edhe ndonjë interes, njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Detyrime të tjera financiare maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet nga interesat dhe fitim ose humbjet nga kursi i këmbimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje nga ç'regjistrimi njihet po ashtu në pasqyrën e të ardhurave ose shpenzimeve.

Detyrimet financiare me VDFH

Këto janë instrumenta financiare të mbajtur për tregtim.

Detyrimet financiare me kosto të amortizuar

Këto janë detyrimet me Shoqërinë Administruese, Bankën Depozitare dhe detyrime të tjera.

iii. Matja e vlerës së drejtë

'Vlera e drejtë' është çmimi që do të arkëtohej nga shitja e një aktivi ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut, në datën e matjes në një treg kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm tek i cili Fondi ka qasje në atë datë.

Kur është e mundur, Fondi mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg quhet "aktiv", në qoftë se transaksionet për aktivin ose detyrimin ndodhin me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacion mbi çmimet në vazhdimësi.

Nëse nuk disponohet një kuotim çmimi në një treg aktiv, atëherë Fondi përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vrojtueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vrojtueshme. Teknika e zgjedhur përmbledh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Fondi mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerave të drejta që pasqyron rëndësinë e përdorimit të faktorëve në këto matje:

- Niveli 1: Faktorë që janë të kuotuar me çmime tregu në tregje aktive të instrumenteve identike;

- Niveli 2: Faktorë të tjerë nga ato të kuotuar me çmime tregu sipas Nivelit 1, dhe që janë të vëzhgueshëm ose drejtpërdrejt (nëpërmjet çmimeve) ose jo në mënyrë të drejtpërdrejtë (nëpërmjet çmimeve të përcaktuara);
- Niveli 3: Faktorë që janë të pavëzhgueshëm. Në këtë kategori përfshihen të gjithë instrumentet financiare për të cilët teknikat e vlerësimit përfshijnë faktorë që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të cilët kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit.

Instrumentat financiarë jo me vlerë të drejtë

Instrumentat financiarë që nuk maten me VDFH përfshijnë:

- Paraja dhe ekuivalentet e saj, detyrime të tjera. Këto janë aktive financiare dhe detyrime financiare afatshkurtra, vlera kontabël e të cilave është afërsisht e njëjtë me vlerën e drejtë, për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër si edhe cilësinë e lartë të aftësisë paguese së tyre; dhe
- Asetet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar. Këto aktive financiare të cilat mbahen për t'u mbledhur, maten me koston e amortizuar.
- Aktiviteti neto që i atribuohet mbajtësve të kuotave. Fondi lëshon dhe ripaguan në rutinën e tij kuotat e mbajtësve në një shumë që është e njëjtë me porcionin e tyre në aktivet neto të Fondit në kohën që ato tërhiqen, dhe llogariten mbi bazë konsistente me atë të përdorur në pasqyrat financiare. Rrjedhimisht, vlera kontabël e aktiveve neto që i atribuohet mbajtësve të kuotave është afërsisht e njëjtë me vlerën e drejtë.

iv. Matja e vlerës së amortizuar

"Kostoja e amortizuar aktiveve financiare ose detyrimeve financiare është shuma në të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare pasi janë zbritur ripagesat e principalit, ose amortizimi i akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për ndonjë diferencë midis vlerës fillestare dhe vlerës në maturim, dhe për aktivet financiare të rregulluar për ndonjë zhvlerësim.

v. Zhvlerësimi

Fondi njeh një zhvlerësim për humbjet e pritshme të kredisë ("HPK") për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar. Për të përcaktuar nëse rreziku i kredisë për një aktiv financiar është rritur në mënyrë të rëndësishme që prej njohjes fillestare të tij, dhe kur vlerëson HPK, Fondi merr parasysh informacionet mbështetëse dhe të arsyeshme dhe që janë relevant dhe të gatshme pa shume kosto dhe punë shtesë. Kjo përfshin analizim të informacionit cilësor dhe sasior, duke u bazuar në historikun dhe eksperiencën e Fondit si edhe duke përfshirë informacione të cilat i përkasin të ardhmes. Fondi supozon se rreziku i kredisë të një aktivi financiar rritet në mënyrë të rëndësishme në rast se ai shfaqet më shumë se 30 ditë në vonesë.

Fondi konsideron si aktive financiare me rrezik të ulët në rastet kur rreziku i kredisë të kundërpartisë është i listuar si BBB+ nga agjenci të mirënjohura të vlerësimit si Standard and Poor's, ose kur aktivet financiare lëshohen nga Qeveria Shqiptare ose nga Banka e Shqipërisë.

Fondi nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare më 30 qershor 2025.

vi. Ç'regjistrimi

Një aktiv financiar ç'regjistrohet kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë nga aktiviteti financiar kanë mbaruar, ose kur Fondi transferon të drejtat për të marrë flukset e parasë në një transaksion në të cilin në mënyrë të qenësishme të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivitetit financiar janë transferuar ose në të cilin Fondi as nuk ka transferuar dhe as nuk ka mbajtur të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia dhe nuk ushtron kontroll mbi aktivitetin financiar.

Në njohje të një aktiviteti financiar, ndryshimi midis vlerës së mbartur të aktivitetit dhe vlerës së dhënë njihet në pasqyrën e fitim humbjes.

c. Paraja dhe ekuivalentet me to

Paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë mjete monetare në llogari rrjedhëse në banka dhe mjete të tjera likuide me maturitet jo më shumë se tre muaj nga data e mbajtjes të cilat mund të jenë subjekt i ndryshimeve jo të rëndësishme në vlerën e tregut dhe që përdoren nga Fondi në manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

d. Të ardhura dhe shpenzime nga interesi

Të ardhura dhe shpenzime nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë interesin mbi aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare të matur me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Interesi efektiv llogaritet në njohjen fillestare të një instrumenti financiar si norma që skanton flukset e ardhshme të pagueshme ose të arkëtueshme përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar në:

- vlerën bruto të aktivitetit financiar; ose
- vlerën me kosto të amortizuar të detyrimit financiar.

Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi, metoda e interesit efektiv aplikohet mbi vlerën bruto të aktivitetit (në rast se aktiviteti nuk është i zhvlerësuar) ose mbi koston e amortizuar të detyrimit financiar.

e. Shpenzime nga tarifa dhe komisione

Shpenzime nga tarifa dhe komisione janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë kohës së kryerjes së shërbimit.

f. Tarifa për Shoqërinë Administruese

Fondi duhet t'i paguajë Shoqërisë Administruese një tarifë prej 2,5% të aktiveve neto, e cila njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë kohës së kryerjes së shërbimit.

g. Tatimi mbi fitimin

Sipas sistemit tatimor në Shqipëri, Fondi është i përjashtuar nga tatimi mbi fitimin.

h. Amortizimi i primit për aktivet me kosto të amortizuar

Amortizimi i primit për aktivet me kosto të amortizuar përfshin të gjithë të ardhurat nga primi i aktiveve me kosto të amortizuar.

i. Vlera neto e aktiveve të fondit

Vlera neto e aktiveve të fondit është e barabartë me totalin e aktiveve minus detyrimet e Fondit.

j. Vlera e kuotës së Fondit të Pensionit Privat Albsig

Vlera e kuotës është e barabartë me vlerën e aktiveve neto të Fondit pjestuar me numrin e kuotave në datën e raportimit. Vlera fillestare e kuotës ka qenë e barabartë me 1.000 Lekë në përputhje me politikën e Fondit.

4. Administrimi i rrezikut financiar

a. Kuadri për administrimin e rrezikut financiar

Fondi investon në instrumente financiare në përputhje me strategjinë e tij të investimit. Portofoli i Fondit të investimit përfshin letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare. Kështu Fondi është i ekspozuar ndaj këtyre rreziqeve nga instrumentet financiare:

- rreziku i kredisë;
- rreziku i likuiditetit;
- rreziqet e tregut; dhe
- rreziku operacional.

b. Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Fondit nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale, pjesërisht ose plotësisht gjë që sjell efekt negativ në aktivet e Fondit.

Politika e Fondit mbi rrezikun e kredisë është minimizimi i ekspozimit të tij ndaj palëve të cilat janë të perceptuara si me rrezik të lartë, dhe të ketë marrëdhënie vetëm me palë të cilat përmbushin standardet e kredisë sipas politikës së investimit të Fondit.

Rreziku i kredisë për investimet në Obligacione të Qeverisë Shqiptare, lidhet ngushtësisht me gjendjen e Qeverisë Shqiptare. Rreziku i kredisë tradicionalisht është vlerësuar si i ulët për letrat me vlerë të qeverisë krahasuar me letra të tjera me vlerë.

Të gjitha veprimet kryhen nëpërmjet Bankës Depozitare, e cila është e aprovuar nga AMF.

Investimet e Fondit janë detajuar si më poshtë: Instrumente të matura me kosto të amortizuar, pa vonesa dhe të pazhvlerësuar.

c. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Fondi mund të mos jetë në gjendje të gjenerojë burime të mjaftueshme monetare për të shlyer plotësisht detyrimet e tij ose mund t'i shlyejë në kushte të cilat janë materialisht jo të favorshme.

Politika e Fondit në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa të jetë e mundur, se gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet kur është e nevojshme, nën kushte normale dhe tensioni, duke përfshirë edhe shlyerjet e vlerësuar të kuotave, pa shkaktuar papranueshmëri humbje ose duke rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Fondit.

Aktivitetet financiare të Fondit përfshijnë Obligacione të Qeverisë Shqiptare të mbajtura me kosto të amortizuar dhe pesha e tyre do ndryshojë në varësi të kushteve të tregut si edhe politikës dhe strategjisë së investimit të Shoqërisë Administruese.

d. Rreziku i tregut

Rreziku i tregut zhvillohet si pasojë e ndryshimeve në:

- a) normat e interesit,
- b) kurset e këmbimit.

Rritja e normave të interesit sjell ulje të vlerës së instrumentit financiar, dhe ulja e normave sjell rritje të vlerës së instrumentit financiar. Shoqëria Administruese, menaxhon rrezikun nga normat e interesit duke zbatuar parimin e menaxhimit të aseteve sipas detyrimeve. Duke u nisur nga fakti që detyrimet e Fondit janë në përgjithësi afatgjatë, Fondi përpiket që të investojë në instrumente afatgjatë.

Luhatjet në kurset e këmbimit sjellin luhajte edhe në vlerën e aktiveve të konvertuar në monedhën vendase Lek. Fondi megjithëse ka parashikuar në alookimin e tij letra me vlerë në monedhë të huaj, alookimi strategjik në to është zero.

e. Rreziku operacional

‘Rreziku operacional’ është rreziku i ndodhjes të një humbjeje direkte ose jo-direkte që mund të lindë si pasojë e një sërë shkaqesh që shoqërojnë procese të tilla si teknologjia dhe infrastruktura që mbështet veprimtarinë e Fondit me instrumentet financiare, qoftë së brendshmi në Fond apo së jashtmi me ata që i ofrojnë shërbime Fondit, dhe nga faktorë të jashtëm të tjerë nga rreziku i kredisë, i tregut apo i likuiditetit, të tillë si ato që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregullatorë dhe standardet e gjithë pranura të sjelljes së investimeve.

Qëllimi i Fondit është të administrojë rrezikun operacional në mënyrë të tillë që të baraspeshojë kufizimet në humbje financiare dhe dëmtimit të reputacionit me arritjen e qëllimit të investimeve për të prodhuar kthim ndaj investitorëve. Shumica e aktiveve të Fondit ruhen nga Banka Depozitare që është Banka e Tiranës.

Shoqëria Administruese ndërton sisteme kontrolli të brendshme dhe procedura duke parandaluar rrezikun e humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabime njerëzore ose të sistemeve brenda Shoqërisë Administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregtimit, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit. Shoqëria për të administruar Fondin përdor një sistem operative i cili është ndërtuar duke respektuar parimin e 4 (katër) syve.

Gjithashtu Banka Depozitare kontrollon aktivitetin e investimeve dhe të transaksioneve me anëtarët (kontributet dhe shlyerjet).

5. Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentet e saj maten me koston e amortizuar ne pasqyrat financiare dhe përbëhen si vijon:

	30 qershor 2025	31 dhjetor 2024
Paraja tek bankat	1,968,776.41	938,619.63
Depozita me afat maturimi deri në tre muaj	10,660,000.00	10,600,000.00
Totali	12,628,776.41	11,538,619.63

6. Aktive financiare me kosto të amortizuar

Aktive financiare me kosto të amortizuar përbëhen nga letrat me vlerë me Qeverinë Shqiptare.

	30 qershor 2025	31 dhjetor 2024
Obligacione Qeveritare	802,821,488.61	678,298,840.80
Totali	802,821,488.61	678,298,840.80

7. Të ardhura nga interesi

	30 qershor 2025	31 dhjetor 2024
Të ardhura nga interesi i aktiveve financiare me kosto të amortizuar	17,723,499.50	14,787,924.50
Të ardhura nga interesi për depozitat	4,500.96	949.32
Totali	17,728,000.46	14,788,873.82

8. Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese

Të pagueshme ndaj Shoqërisë Administruese paraqet vlerën e tarifës administrimi e përlogaritur në bazë ditore të Vlerës Neto të Aktiveve të Fondit, si dhe penalitet për tërheqje të parakohshme nga Fondi, përkatësisht shpenzimi për muajin qershor 2025:

	30 qershor 2025	31 dhjetor 2024
Tarifa e administrimit	1,682,762.11	1,472,481.42
TOTALI	1,682,762.11	1,472,481.42

9. Detyrime të tjera

Detyrime të tjera më 30 qershor 2025 janë si vijon:

	30 qershor 2025	31 dhjetor 2024
Detyrime ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve	602,813.62	307,645.58
Detyrime ndaj subjektit (diferencë e kaluar gabim nga subjekti)	-	5,000.00
TOTALI	602,813.62	312,645.58

10. Tarifa e Shoqërisë së Administrimit

Tarifa e Shoqërisë së Administrimit në vlerën 9,432,786.27 Lekë përfaqëson shpenzimin e ndodhur përgjatë periudhës dhe përlllogaritet si 2.5% (në bazë vjetore) e vlerës neto të aktiveve. Ky shpenzim përlllogaritet në bazë ditore.

Përgatiti:

Irfan LAMI

Drejtor i Departamentit të Financës Albsig Sh.a
(funksion i deleguar)

Miratoi:

Elton KORBI

Administrator i Përgjithshëm Albsig Invest Sh.a